

VENDIM
Nr. 214, datë 25.3.2021

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE
TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, 30 e 151, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës “b”, të pikës 6, të kreut II, shtohet shkronja “b/1”, me këtë përmbajtje:

“b/1) janë të pajisur me leje qëndrimi të vlefshme, të lëshuar nga autoritetet kompetente të Emirateve të Bashkuara Arabe.”.

b) Në aneksin nr. 3, “Lista e shteteve, shtetasit e të cilëve hyjnë pa viza në Republikën e Shqipërisë dhe dokumenti duhet të paraqesin”, bëhet ndryshimi, si më poshtë vijon:

“Arabi Saudite, Bahrein, Egjipt, Indi, Katar, Oman, Rusi dhe Tailandë me dokumentin pasaportë, për periudhën 1 prill–31 dhjetor 2021.”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe